



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2010/2011.

TESTI 3

MATEMATIKË

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra. Për zgjidhjen e këtij testi janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjesh, të shkruash diçka etj.

Ki kujdes për mënyrën se si duhet të përgjigjesh. Gjatë punës mund të përdorësh gomën, vizoren, trekëndëshin dhe kompasin. Nuk guxon ta përdorësh telefonin/celularin dhe kalkulatorin (digitronin).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.


Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.

Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps. Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë. Nëse e vëren se dikund ke gabuar asaj detyre hiqi vizë, dhe shkruaje qartë cila përgjigje mendon se është mirë.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

Të dëshirojmë sukses në provim!



1. Janë dhënë numrat

$-3,1$

$-12,2$

$0,03$

$0,3$

a) Më i vogli nga këta numra është

b) Më i madhi nga këta numra është

2. Llogarit dhe shkruaj rezultatin përkatës.

a) $-6 : 2 =$

b) $-6 - 2 =$

c) $-6 \cdot 2 =$

d) $-6 + 2 =$

3. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Vlera e fuqisë $0,3^2$ është:

a) 0,06

b) 0,6

c) 0,09

d) 0,9

4. Funkzioni është dhënë me formulë $y = 2x + 1$. Llogarit vlerat përkatëse të ndryshoreve x dhe y dhe plotëso tabelën.

x	0		4
y		5	

5. Sa është perimetri i rrethit rrezja e të cilit është 7 cm?
Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 14 cm
- b) 49 cm
- c) 14π cm
- d) 49π cm

6. Shpendi në orën e arsimit teknik e ka bërë kutinë prej kartoni në formë të kubit brinja e të cilit është 5 cm. Sa është sipërfaqja e kutisë së Shpendit?

Sipërfaqja e kutisë së Shpendit është _____ cm².

7. Fushën e ndryshme në tabelë plotësoje me njësinë përkatëse matëse.


	Numri matës	Njësia matëse
Sipërfaqja e një klase	50	
Largësia midis Beogradit dhe Nishit	220	
Masa e një molle	120	
Kohëzgjatja udhëtimi me aeroplan nga Beogradi deri në Athinë.	2	

8. Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.
Largësia midis Beogradit, kryeqytetit të Serbisë, dhe Londrës, kryeqytetit të Mbretërisë së Bashkuar, është 1688,97 km. Kjo është përafërsisht:

- a) 1 500 km
- b) 1 600 km
- c) 1 700 km
- d) 1 800 km



9. Diagrami tregon ndryshimet në numrin e ditëve me diell gjatë vitit sipas muajve.




a) Më së paku ditë me diell në vit ka pasur në muajin _____.

b) Më së shumti ditë me diell në vit ka pasur në muajin _____.

10. Të pyetur cilin sport e do më së shumti në një shkollë janë fituar rezultatet të cilat janë pasqyruar me diagram rrethor.

Plotëso tabelën me të dhënat nga diagrami rrethor.

Sporti	Përqindja e nxënësve
	10%
	25%
	30%
	35%



- 11.** Në 300 g të përzierjes së çajit $\frac{1}{6}$ është mendër, $\frac{3}{10}$ është balsam, kurse pjesa tjetër është çaj kamomileje. Sa gramë kamomileje janë në atë përzierje çaji?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

- a) 150 g
- b) 160 g
- c) 170 g
- d) 180 g



- 12.** Janë dhënë binomet $M = 6m - n$ dhe $N = -m + 3n$. Thjeshtëso shprehjen.

a) $M + N =$

b) $M - N =$


c) $M \cdot N =$



- 13.** Sa është këndi i jashtëm γ_1 i cili i përgjigjet kulmit C të katërkëndëshit $ABCD$ në fotografi?

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.


- a) 47°
- b) 57°
- c) 67°
- d) 77°



- 14.** Naimi shkon në ekskursion në Vjenë. Rruga dhe qëndrimi i kushtojnë 420 euro dhe i paguan në gjashtë këste të barabarta. Çfarë shume duhet të paguajë Naimi në dinarë për këstin e parë, nëse në ditën e pagimit një euro e ka pasur vlerën 105 dinarë?

Naimi për këstin e parë duhet të paguajë _____ dinarë.

- 15.** Në bazë të koordinatave të dhëna të pikës A vizato në sistemin koordinues pikën $M(1, -2)$.



- 16.** 3Për sa është sipërfaqja e piramidës së rregullt katërfaqëshe tehu bazë i të cilës është 6 cm dhe lartësia e brinjës anësore (apotema) 4 cm më e madhe se sipërfaqja e prizmit të rregullt katërbrinjësh tehet bazë të së cilës janë 3 cm dhe lartësia 4 cm.

Tregoje procedurën.

Sipërfaqja e piramidës është më e madhe për _____ cm^2 .

- 17.** Në fund të gjysmëvitit të parë nxënësit e paraleles VIII₁ i kanë pasur 1320 mungesa. Në të njëjtën periudhë nxënësit e paraleles VIII₂ i kanë pasur 15% më shumë mungesa nga VIII₁. Sa mungesa i kanë pasur nxënësit e paraleles VIII₂?
Tregoje procedurën.

Nxënësit e paraleles VIII₂ i kanë pasur _____ mungesa.

- 18.** Llogarite vlerën e shprehjes.

$$2 \cdot \left(\left(\frac{4}{7} + \left(1 - \frac{1}{2} \right) \right) : \left(\frac{3}{7} : (0,12 : 0,3) \right) \right) - 3 \frac{1}{4}$$

Tregoje procedurën.

Vlera e shprehjes është _____.

- 19.** Për cilat vlera të ndryshores x është shuma e shprehjes $\frac{6-2x}{5}$ dhe $\frac{3-2x}{7}$ më e vogël ose e barabartë me -3 ?

Tregoje procedurën.

Përgjigja: _____



- 20.** Firma: "123 AC" planifikon të blejë truallin në të cilin do të ndërtojë një sallë. Kanë arritur tri oferta për truall. Trualli i parë e ka sipërfaqen 0,008 km² dhe çmimi i këtij trualli është 3 936 000 dinarë. Trualli i dytë e ka sipërfaqen 0,16 ha dhe çmimi i këtij trualli është 809 600 dinarë. Trualli i tretë e ka sipërfaqen 45 a dhe çmimi i këtij trualli është 2 196 000 dinarë.

Sa është çmimi më i ulët për një metër katror nga trojet e ofruara?

Tregoje procedurën.

Çmimi më i ulët për një metër katror është _____ dinarë.

Rezultati në testin e matematikë

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E paplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	